



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 10.07.2013
Nr. 0204-914

PËR: Ramadan Muja, Kryetar i Komunës së Prizrenit
Njazi Kryeziu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT,
NR. 01/011-8286 të Pranuar me datë, 09.07.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me nenin 82 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit nr. 01/011-8286 të miratuar me datën 04.07.2013 nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Akti juridik i listuar si vijon, ka efekt të plotë juridik.

- Vendim nr. 01/011-8286 për dhënien në shfrytëzim të pronës së Komunës, Tarikatit Saadi për ndërtimin e Teçës së Madhe.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum, 10.07.2013
br. 0204-914

Za: Ramadan Muja, Gradonačelnik opštine Prizren
Njazi Kryeziu, Predsedavajući Skupštine opštine Prizren

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke opštine Prizren ,
br. 01/011-8286 primljeno dana , 09.07.2013

Poštovani

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke br. 01/011-8286 odobreno dana 04.07.2013 od strane Skupštine opštine Prizren , **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom br. 03/z-040 o lokalnoj samoupravi .i zakonom br. 04/z-144 o davanju na koristi i razmenu nepokretno opštinsko zemljište .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je, kao što sledi:

- Odluka br. 01/011-8286 o davanju na koristi opštinsko zemljište , Tarikatu Saadi o izgradnji velike Teče.

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministritet Lokale Samoprave i Administracije Ministry of Local Government Administration			
Data Datum Date			
09.07.2013			
Nënsia organizative	Nr. i lëndës	Shënica	Vlera
-III-	0204-814		

Në bazë të nenit 10, al.1, pika 4 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 12, nenit 14, alineja 1, të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 27 alineja 1, të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas shqyrtimit të shkresës së MAPL, Nr.0204-681, të datës 4. 6. 2013, për rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit nr. 01/011-5962, të datës 27 prill 2013, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e vetë të mbajtur me 4 korrik 2013, morri këtë:

V E N D I M

PËR RIKONFIRMIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT Nr. 01/011-5962, TË DATËS 27 PRILL 2013 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PËRKOHSHËM TË PRONËS KOMUNALE

"Neni 1"

Rikonfirmohet vendimi i Kuvendit nr. 01/011-5962, të datës 27 prill 2013, për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale me tekstin në vijim:

Neni 1

Aprovohet kërkesa e Bashkësisë fetare Teqja-Tarikati Saadi - ish pronar, për dhënie në Pronës Komunale në shfrytëzim, ashtu që lejohet dhënia në shfrytëzim e ngastres kadastrale nr.01882-0 ZK-Prizren.

Neni 2

Ngastra kadastrale nr. 01882-0, ZK-Prizren, në vendin e ashtu quajtur „VLLAZNIM BASHKIM, që evidentohet sipas Certifikatës nr. 18-7813, të datës 13.05.2013, (si shtëpi-nuk ekziston-shembur në sipërfaqe prej 393m/2 dhe oborr në sipërfaqe prej 204m/2, (nuk ka pas dhe nuk ka kontest gjyqësor rreth kësaj ngastre) respektivisht në sipërfaqe të përgjithshme prej 597m2, e cila e evidentohet si pasuri shoqërore KK-Prizren.

Neni 3

Prona në fjalë e përshkruar si në nenin 1 dhe 2, të këtij vendimi jepet në shfrytëzim ish pronarit me qëllim të rindërtimit të Teqes në formën dhe vendin ku ka qenë deri në rënimin e dhunshëm, nga ish regjimi komunist në përputhje të plotë, në pajtim me Planin që do të lejohet nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore-Historike në Prizren. Objekti i rindërtuar i Teqes, do të shërbejë për zhvillimin e aktiviteteve fetare nga kjo Bashkësi fetare

Neni 4

Afati Kohor për dhënie në shfrytëzim të pronës Komunale, do të jetë në pajtim me nenin 6 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe do të jetë për 99 (nëntdhjetenë) vite.

Neni 5

Me Rindërtimin e Objektivit të Teqes, Komuna e Prizrenit, do të kontribuoj në rindërtimin e Teqes, që ka qenë objekt me vlerë kulturo-historike dhe në bazë të pëlqimit paraprak të dhënë, shfrytëzuesi do ta lenë në shfrytëzim në kohë të pacaktuar të njëjtën në rast nevojës të Komunës apo organeve qeveritare të objektit në fjalë.

Neni 6

AUTORIZOHET Kryetari i Komunës të nënshkruaj kontratën përkatëse për dhënie në shfrytëzim për qëllime dhe nën kushte të cekura më lartë.

Neni 7

Me këtë vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Sektori i Çështjeve Pronësore Juridike dhe Avokati Publik Komunal.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Prizrenit dhe do të shpallet në "Kumtar".


KOMUNA E PRIZRENIT

Kuvendi i Komunës

Nr: 01/011-8286

Më: 4 korrik 2013

Prizren



Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu